| **Titulli/Emërtimi i projektit** | **Sistemim Asfaltim “Rruga Strikçan”** |
|---|---|
| Tipi i projektit | Infrastrukturë |
| Vendndodhja e projektit | Njësia Administrative Zërqan |
| Buxheti total i projektit | 18,745,406 me tvsh ALL |
| Përshkrimi i projektit | Segmenti rrugor i propozuar lidh Zallsopot, Strkcan me qendrën<br>administrative Zërqan dhe me Bashkinë Bulqizë. Rruga është e shtruar më çakull dhe e kalueshme me shumë vështirësi. Në shumë pjesë ka mungesë të shtresave rrugore, nuk ekzistojnë bankinat, ka mungesë të elementëve të domosdoshëm të infrastrukturës rrugore, ujrat rrjedhin në trup të rrugës pasi kanalet anësore dhe veprat e artit mungojnë plotësisht. Rruga asnjëherë nuk ka pasur një përmirësim apo rikonstruksion tërësor, por vetëm mirëmbajtje rutinë. Gjendja e keqe e rrugës është një pengesë serioze për:<br><br>(i) transportin e njerëzve dhe të mallrave<br>(ii) aksesin ndaj shërbimeve bazë<br>(iii) punësimin dhe zhvillimin ekonomik<br>(iv) lëvizjen e nxënësve për në shkollë<br><br>Në sistemim asfaltim parashikohet të përfshihet një segment ku pjesa kaluese asfalt me gjersi 3.6 m dhe në të dyja anët bankinë me gjerësi 2 x 0.50 m, vepra arti, kanale anësore, mure pritës dhe mbajtës si dhe kalime me tombino. Përfitues të drejtëpërdrejtë do të jenë 1000 banorë. |
| Qëllimi dhe objektiva | Qëllim i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetësës, me objektiv<br>♣ Të përmirësohet infrastruktura e transportit<br>♣ Të përmirësohet aksesi në shërbimet bazë<br>♣ Të përmirësohet aksesi në tregjet e zonës |

| | |
|---|---|
| | ♣ Të rriten mundësitë për zhvillim social-ekonomik |
| Rezultatet e pritshme | Ndër rezultatet e pritshme janë:<br>♣ Ulje të kostove të transportit<br>♣ Rritja e të ardhurave dhe përmiresim i mirëqenies ekonomike<br>♣ Rritja mundësive për punësim dhe të aksesit në tregun e punës<br>♣ Frenim i largimit të popullsisë<br>♣ Uljen e shpenzimeve për mirëmbajtjen e automjeteve<br>♣ Gjallërim të jetës sociale |
| Rendi prioritar | Projekti është në rendin prioritar për vitin 2019 |
| Qendrueshmëria e projektit | Pranë bashkisë do të ngrihet njësia për administrimin dhe mirëmbatjen e infrastrukturës rrugore lokale. Fondi për administrimin dhe mirembajtjen e rrugës do të parashikohet çdo vit në buxhetin e bashkisë. |
| Aktivitetet e projektit | ♣ Aplikimi tek fondi i Rajoneve apo tek ndonjë donator tjetër<br>♣ Miratimi i lejeve administrative<br>♣ Zbatimi i projektit |
| Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis | Ka ndikim në mjedis, por në bazë të masave zbutëse të propozuar në studimin e ndikimit në mjedis do të minimizohet ndikim |
| Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim | Projekti për përmirësimin e këtij segmenti është i hartuar dhe ndodhet në bashki me të gjithë specifikimet teknike, relacionin, preventivin, projektit e zbatimit dhe studimin e ndikimit në mjedis. |